



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

*Nr. 43 Datë 30.04.2013*

**MBI**

**NDRYSHIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË  
CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
BURIMET E ENERGJISË SË RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma m iv), nenit 9 dhe të nenit 39, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.04.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Vendosi:**

- Në Rregullat dhe procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, miratuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve, nr. 9, datë 21.02.2007, bëhet një ndryshim dhe një shtesë në paragrafin e dytë, neni 7 të tij:

*“Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet për një central prodhues të vënë në operim për herë të parë paralel me rrjetin elektrik pas 2.11.2000.*

*Mund të kualifikohen si burime të rinovueshme energjie dhe Hec-et me fuqi të instaluar nën 10 MW të vena në punë jo më pak se 15 vjet më parë dhe që janë objekt i fuqizimit dhe ripunimit total pasi të verifikohen në vend keto punime.*

*Mund të kualifikohen si burime të rinovueshme energjie dhe Hec-et me fuqi të instaluar të barabartë, apo mbi 10 MW, të vena ne pune jo me pak se 30 vjet me parë dhe qe jane objekt i fuqizimit dhe ripunimit total pasi te verifikohen ne vend keto punime.*

*Kerkesa per kualifikim mund te paraqitet gjithashtu per nje central prodhues energjie të rinovushme dhe ne fazen e projektimit ose ne fazen e ndertimit.”*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**

**Ne mungese dhe me porosi**

**Entela SHEHAJ**